



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 6 lidhur me nenin 7, pika 3, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012” nenit 5, lidhur me nenin 11, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.01.2019, miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**JEPET PËLQIMI-** për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri në 50, (pesëdhjetë) vite të pronës së paluajtshme të komunës, për interes publik për destinimin e cekur me poshtë;

**Parcela,** kadastrale, **P72116020-00917-0**, sipas certifikatës së pronës, Nr-213/2015-2, e cila gjendet në vendin e quajtur “Livadhet e verdha” në fshatin Gjinoc Komuna e Suharekës, me sipërfaqe prej **12435m<sup>2</sup>** dhe **objekti** që është në ndërtim e sipër me sipërfaqe të përgjithshme të bazamentit **1320m<sup>2</sup>** pasurisë shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, me destinim të caktuar **“Ofrimin e shërbimeve për personat pa përkujdesje familjare”**.

### Neni 2

Parcela së bashku me objektin e cekur në neni 1, të këtij vendim jepet pa kompensim, komisioni për zbatimin procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, ka kompetencë, autorizimet dhe përgjegjësit të përcakton kushtet dhe kriteret specifike për këtë çështja pasi që objekti në fjalë është në ndërtim e sipër dhe përfutuesi ka për të bërë investime në këtë objekt me qëllim të funksionalizimit të objektit për destinimin e caktuar më lartë.

### Neni 3

**OBLIGOHET-**Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastër dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës se paluajtshme të Komunës, që të zhvilloj procedurat e konkurrimit të hapur, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012) dhe të Rregullores (QRK), Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

### Neni 5

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi me numër, 01-Nr-16-9017, i datës 01.09.2015.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-016-778P  
Më datë 31.01.2019

